



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1572/ 5 prot.

Datë 22.07.2024

V E N D I M
Nr. 911/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-08407-06-06-2024, me objekt loti 2 “*Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Berat*”, me fond limit: 12,333,432 (*dymbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tremijë e katërqind e tridhjetë e dy*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 08.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Wash & Go Laundry*” SHPK me NIPT L97008205L dhe adresë: Rruga “Gjergj Araniti”, Lagjia Pavarësia, Pallati Nr. 4, Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për*

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.06.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-08407-06-06-2024, me objekt loti 2 “Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Berat”, me fond limit: 12,333,432 (dymbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tremijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 08.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Me datë 13.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4208 dhe me nr. 1572/2024 prot., datë 13.06.2024, e operatorit ekonomik “Wash & Go Laundry” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, si më poshtë vijon:

Kërkojmë në lidhje me Shtojca 10, LOTI 2 ME OBJEKT shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Beratë të realizohen ndryshimet vijuese:

Në pikën 2.3.5 (a) të ndryshohen kërkesat për drejtuesin teknik duke hequr kërkimin për diplomën e shkollës së lartë ose në mënyrë alternative pranimin e diplomave të formimit profesional (shkollë e mesme profesionale me specialitete teknike si mekanike, elektrike) ose kurse të formimit profesional që lidhen me objektin e aktivitetit psh. Formim profesional në lidhje me menaxhimin e aktiviteteve të higjenës, së pastrimit e të lavanderive në përgjithësi. Duke qenë se dokumentet e procedurës së prokurimit nuk përcaktojnë se çfarë vlere të shtuar jep dhe çfarë lidhje ka diploma e shkollës së lartë me shërbimin konkret, ky kërkim është jo proporcional dhe kufizues i konkurrencës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 3, 36, 77 të ligjit të prokurimit. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka një drejtim universitar/të shkollave të larta që lidhet me shërbimin e kërkuar, ndaj kërkitimi i diplomës së shkollës së lartë, pa specifikuar se çfarë diplome kërkohet e kthen këtë kërkim në jo proporcional, shmangës së konkurrencës dhe pa lidhje organike me objektin e prokurimit. Në formë arsyetimi kundërshtues, shtrojmë pyetjen se çfarë vlere të shtuar ka një diplomë e shkollës së lartë psh. Në gjuhë të huaj ose histori gjeografi në raport me një diplomë të shkollës së mesme profesionale në drejtimin mekanik ose elektrik ose një diplome të shkollës së mesme plus një kurs i formimit profesional në menaxhim ose formim në aktivitetin e administrimit/drejtimin të lavanderive. Kërkojmë në këtë drejtim modifikimin e këtij elementi/kërkesës për drejtuesin teknik duke lejuar në mënyrë alternative, përveç diplomës së shkollës së lartë edhe certifikime e formime alternative profesionale.

Në pikën 2.3.7 të shtojcës më sipër në lidhje me kërkesat për makinat larëse profesionale, të shtohet edhe kërkesa që këto të jenë të certifikuara në lidhje me përdorimin me material të butë të kontaminuar me materiale biologjikë, radiologjikë, kimikë. Kjo kërkesë është imperative në plotësim të kërimit për certifikatën SSH EN 14065:2016 dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të pacientëve dhe punonjësve të spitalit dhe të tretëve që realizojnë shërbime aty.

Në pikën 2.3.7 është e nevojshme të shtohet barriera ndarëse, një mjet teknik i nevojshëm në të tilla procese të trajtimit të larjes së materialeve të buta me origjinë spitalore. Në lidhje me këtë, ky mjet ka qenë prezent në procedura të ngjashme prokurimi dhe nuk justifikohet heqja e tij. Në shtojcën nr. 7 LOTI 2 me objekt Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Beratë në lidhje me kërkesën, cit. Teshat të pastrohen mirë me detergjent të Certifikuar dhe zbutës teshash, të

përcaktohen më mirë certifikatat e nevojshme të detergjentit dhe zbutësit të teshave të cilat duhet të jenë produkte CE. Nevojitet të bëhet kjo ripërsëritje pasi lidhet me parashikimin e shtojcës 10, pika 2.3.10, cit. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër shërbimin e larjes me produkte, cilësia CE/ dhe ose/të pajisur me certifikatë konformiteti.

Në pikën 2.3.5 të shtojcës 10 parashikohet minimumi i stafit të nevojshëm për shërbimin në Lotin 2, ku parashikohet nevoja për 1 punonjës drejtues teknik, 2 punonjës në AK dhe 2 punonjës në lavanderi. Mendojmë se numri i nevojshëm për punonjës në lavanderi duhet të jetë minimumi 3 duke qenë se përdorimi i disa proceseve, psh ruli (i kërkuar në listën e pajisjeve) kërkon minimalisht 2 punonjës. Një zgjidhje alternative mund të ishte të mbahej nr. 5 dhe të kërkohej 1 drejtues teknik dhe një punonjës në AK dhe 3 punonjës në lavanderi. Gjithashtu ky parashikim nuk merr në konsideratë rezervën e nevojshme të fuqisë punëtore në lidhje me pushimet vjetore, pushimet për shkak të punës në ditët e pushimit javor, mungesës në punë për shkak të problemeve në shëndet, apo rasteve të tjera të parashikuara nga Kodi i punës.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 421/6, datë 19.06.2024, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 1572/2 prot, datë 20.06.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar kthim - përgjigjen e operatorit ekonomik ankimues pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i së cilës rezultoi, se ka vendosur mos pranimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e kriterit 2.3.5, të dokumenteve standarde të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi me pretendimin se: “Në pikën 2.3.5 (a) të ndryshohen kërkesat për drejtuesin teknik duke hequr kërkimin për diplomën e shkollës së lartë ose në mënyrë alternative pranimin e diplomave të formimit profesional (shkollë e mesme profesionale me specialitete teknike si mekanike, elektrike) ose kurse të formimit profesional që lidhen me objektin e aktivitetit psh. Formim profesional në lidhje me menaxhimin

e aktiviteteve të higjenës, së pastrimit e të lavanderive në përgjithësi. Duke qenë se dokumentet e procedurës së prokurimit nuk përcaktojnë se çfarë vlere të shtuar jep dhe çfarë lidhje ka diploma e shkollës së lartë me shërbimin konkret, ky kërkim është jo proporcional dhe kufizues i konkurrencës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 3, 36, 77 të ligjit të prokurimit. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka një drejtim universitar/të shkollave të larta që lidhet me shërbimin e kërkuar, ndaj kërkitimi i diplomës së shkollës së lartë, pa specifikuar se çfarë diplome kërkohet e kthen këtë kërkim në jo proporcional, shmangës së konkurrencës dhe pa lidhje organike me objektin e prokurimit. Në formë arsytimi kundërshtues, shtrojmë pyetjen se çfarë vlere të shtuar ka një diplomë e shkollës së lartë psh. Në gjuhë të huaj ose histori gjeografi në raport me një diplomë të shkollës së mesme profesionale në drejtimin mekanik ose elektrik ose një diplomë të shkollës së mesme plus një kurs i formimit profesional në menaxhim ose formim në aktivitetin e administrimit/drejtimin të lavanderive. Kërkojmë në këtë drejtim modifikimin e këtij elementi/kërkesës për drejtuesin teknik duke lejuar në mënyrë alternative, përveç diplomës së shkollës së lartë edhe certifikime e formime alternative profesionale. Në pikën 2.3.5 të shtojcës 10 parashikohet minimumi i stafit të nevojshëm për shërbimin në Lotin 2, ku parashikohet nevoja për 1 punonjës drejtues teknik, 2 punonjës në AK dhe 2 punonjës në lavanderi. Mendojmë se numri i nevojshëm për punonjës në lavanderi duhet të jetë minimumi 3 duke qenë se përdorimi i disa proceseve, psh ruli (i kërkuar në listën e pajisjeve) kërkon minimalisht 2 punonjës. Një zgjidhje alternative mund të ishte të mbahej nr. 5 dhe të kërkohej 1 drejtues teknik dhe një punonjës në AK dhe 3 punonjës në lavanderi. Gjithashtu ky parashikim nuk merr në konsideratë rezervën e nevojshme të fuqisë punëtore në lidhje me pushimet vjetore, pushimet për shkak të punës në ditët e pushimit javor, mungesës në punë për shkak të problemeve në shëndet, apo rasteve të tjera të parashikuara nga Kodi i punës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 10/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, kapaciteti teknik, pika 2.3.5, është përcaktuar si më poshtë:

2.3.5. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
a)	Drejtues Teknik	1 (një)
b)	Punëtore në Lavanderi	2 (dy)
d)	Punonjë shërbimi në reparte të AK	2 (dy)
	Totali i punonjësve	5 (pesë)

- a) Drejtuesi Teknik duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.
Për Drejtuesin Teknik, OE duhet të paraqesë:
- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si drejtues teknik;
 - Diplomë e arsimit të lartë;

- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën e kërkuar.

b) Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, dhe punonjësit e shërbimit në Reparte të AK të paraqitet vetëm kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Të dhënat për punonjësit e kërkuar që do të deklarohen, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.2. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.3. Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.1.4. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.5. Në nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.*

III.1.6. Në nenin 17 “Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet”, seksioni 2 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

1. *Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.*
2. *Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.*
3. *Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:*
 - a) *emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;*
 - b) *llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;*
 - c) *të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;*

ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimit apo përdorimit të së mirës;

d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;

dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);

e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

ë) adresën për komunikim;

f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

III.1.7. Në nenin 20 “Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë”, seksioni 2 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

1. QKL-ja merr në shqyrtim paraprak, sipas pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

2. QKL-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kriterëve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate, sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të tjera të licencimit/autorizimit/lejes bëhet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni.

3. Nëse QKL-ja konstaton njëri nga shkaqet e refuzimit, ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.

4. Në rast të kundërt, QKL-ja publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionet e tjera, që shqyrtojnë përmbushjen e një apo të disa kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencë të tyre.

5. Institucionet e tjera, brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektimin, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përmbushjen ose mospërmbushjen e kriterëve përkatëse. Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.

6. Nëse akti i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është, paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtit kriter apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institucion tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.

7. Afati i caktuar, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, është afati për shqyrtimin e përmbushjes ose jo të kriterit përkatës nga institucioni tjetër dhe përcaktohet nga Këshilli i Ministrave për çdo

kategori/nënkategori. Afati fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKL-së, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.

9. Jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i afit të fundit dhe më të gjatë, sipas pikës 5 apo 6 të këtij neni, QKL-ja merr një vendim përfundimtar për kërkesën e paraqitur.

10. Nëse, qoftë edhe një nga institucionet e tjera ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKLja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundër QKL-ja vendos, përkatësisht, miratimin.

III.1.8. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha III “Mjedisi dhe burime mjedisore bazë”, parashikohet shprehimisht:

12 1. Leje Për ndikimin në mjedis.

13 2. Licence Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

14 3. Licence Importi i mbetjeve për qëllim riciklimi, përpunimi, dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozon-holluese.

III.1.9. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjetë qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha III “Mjedisi dhe burime mjedisore bazë”, Kategoria III.2 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.”, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e “shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ” është kategoria III.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) “veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis” me kodin III.2.A;

b) “veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.B.

3. Licencat e kategorisë III.2 jepen pa afat kohor.

8. Licencat për nënkategorinë III.2.B jepen për çdo vend ku kryhet veprimtaria.

9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

10. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për kategorinë III.2.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë.

11. Licencimi i nënkategorisë III.2.B bëhet sipas procedurës së grupit III.

a) Institucioni tjetër, që verifikon plotësimin e kriterëve të licencimit për nënkategorinë III.2.B është struktura e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e caktuar me udhëzim të ministrit sipas kompetencës territoriale në vendin ku ushtrohet veprimtaria. Vendimi bazohet në dokumentet provuese dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve përkatëse të licencimit. b) Afati i marrjes së vendimit është 30 ditë.

IV. DATA E FILLIMIT TË LICENCIMIT SIPAS KËTIJ VENDIMI

12. Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më datë 9.6.2009.

III.1.10. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.11. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar: *“Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, frekuencës së ekzekutimit të kontratës/ava, që do të lidhen dhe termave të referencës, hartuar nga AK. Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshin shërbimi i lavanderisë, si më poshtë: Drejtuesi teknik ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të lavanderisë, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur përgjegjësi për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Vitet e eksperiencës për drejtuesin teknik, janë vendosur duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e shërbimit, objekt prokurimi dhe kryerjen e tij në përputhje cilësinë dhe me oraret e vendosura nga AK. Disponimi i punëtorëve në lavanderi siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset e larjes, tharjes, hekurosjes, paketimit, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar. Punonjës shërbimi në reparte janë të nevojshëm për të kryer proceset e marrjes së materialeve nga spitali dhe transportimin e tyre në spital. Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”.*

III.1.12. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi disponueshmërinë nga operatorët ekonomikë të 1 *Drejtuesi Teknik*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të dëshmojnë se disponojnë edhe leje mjedisore Tipi B “Pastrim kimik”, ndërkohë që në Vendim Nr. 538, Datë 26.5.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen

Nga Apo Njëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (Qkl) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta”, në nenin 1 përkufizime përcaktohet se b) “Drejtues teknik” funksioni/ne që kanë përgjegjësinë teknike e profesionale, në emër të subjektit që licencohet/lejohej, e që sipas sferës konkrete të veprimtarisë, mund të marrë emërtime të veçanta rast për rast; Referuar procesverbalit të hartimit të kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, si dhe kriterëve kualifikuese KPP konstaton, se kriteri në lidhje me kërkesën e drejtuesit teknik me arsim të lartë është i lidhur indirekt me kriterin e disponimit të lejes mjedisore, ndaj dhe kërkesa përse i përket disponimit të një drejtuesi teknik nuk është diskriminuese dhe e ekzagjyeruar. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e një drejtuesi teknik është e nevojshme, por autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të përcaktuar profilin e drejtuesit teknik në mënyrë që të mos krijojë konfuzion tek operatorët ekonomik mbi mënyrën e përmbushjes së kriterit dhe akoma më tej tek komisioni vlerësimit të ofertave gjatë fazës së vlersimit të tyre. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në kushtet kur synimi i autoritetit kontraktor, për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, sa i përket personelit të nevojshëm, realizohet nëpërmjet plotësimit të kërkesës për disponimin e 1 drejtuesi teknik dhe përcaktimi diplomë e arsimit të lartë pa përcaktuar profilin do të krijonte konfuzion tek operatorët ekonomik të interesuar, ndaj është i nevojshëm për autoritetin kontraktor në funksion të realizimit të qëllimit të tij, sikurse është realizimi me sukses i kontratës, të marrë masa dhe të saktësojë profilin e drejtuesit teknik, në mënyrë që të mos krijojë premisa për një vlersim subjektiv gjatë fazës së vlersimit të ofertave. Ndërsa në lidhje me shtimin e punonjësve të në lavanderi nga 2 në 3 punonjës dhe uljen e punonjësve të shërbimit në reparte të Ak nga 2 në 1 punonjës, Komisioni Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentat e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve si dhe specifikimeve teknike dhe termave të referencës, rezulton se autoriteti kontraktor në bazë të nevojave të tij të arsyetuara ka vendosur ndarjen e punonjësve sipas kërkesave.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendime e ankimuesit se “Në pikën 2.3.7 të shtojcës më sipër në lidhje me kërkesat për makinat larëse profesionale, të shtohet edhe kërkesa që këto të jenë të certifikuara në lidhje me përdorimin me material të butë të kontaminuar me materiale biologjikë, radiologjikë, kimikë. Kjo kërkesë është imperative në plotësim të kërimit për certifikatën SSH EN 14065:2016 dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të pacientëve dhe punonjësve të spitalit dhe të tretëve që realizojnë shërbime aty. Në pikën 2.3.7 është e nevojshme të shtohet barriera ndarëse, një mjet teknik i nevojshëm në të tilla procese të trajtimit të larjes së materialeve të buta me origjinë spitalore. Në lidhje me këtë, ky mjet ka qenë prezent në procedura të ngjashme prokurimi dhe nuk justifikohet heqja e tij. Në shtojcën nr. 7 LOTI 2 me objekt Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Beratë në lidhje me kërkesën, cit. Teshat të pastrohen mirë me detergjent të Certifikuar dhe zbutës teshash, të përcaktohen më mirë certifikatat e nevojshme të detergjentit dhe zbutësit të teshave të cilat duhet të jenë produkte CE. Nevojitet të bëhet kjo ripërsëritje pasi lidhet me parashikimin e shtojcës 10, pika 2.3.10, cit. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër shërbimin e larjes me produkte, cilësia CE/ dhe ose/të pajisur me certifikatë konformiteti”, KPP gjykon, se këto në thelb kanë të bëjë me shtim të kriterëve të kualifikimit dhe jo me pretendime për modifikimin e kriterëve, diskriminues, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësisia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka

parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kritere kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kritere të reja që do të rëndonin pozitat e operatorëve ekonomik të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën së operatorit ekonomik “*Wash & Go Laundry*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-08407-06-06-2024, me objekt loti 2 “*Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Berat*”, me fond limit: 12,333,432 (*dymbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tremijë e katërqind e tridhjetë e dy*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 08.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
 2. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*Wash & Go Laundry*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

